



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 185/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur ndaj Jeton Tifekut kryesues i Vendvotimit (VV) nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit të zgjedhjeve në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06. 2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Kaçanik, me të cilën pretendohet se me datën 17.06.2012 në Qendrën e Votimit (QV) 0706D/02R, se kryesuesi i VV nga PDK-ja Jeton Tifeku nuk e ka lejuar vëzhguesin Ngadhjim Hagjosaj të shkruaj vërejtjet tek libri i ankesave. Me këtë rast parashtuesi i ankesës pretendon se është shkelur Rregulla Zgjedhore 9/2009 neni 4 paragrafi 1 dhe 2.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga ana e LVV-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.06.2012, në ora 15:00.

PZAP-i, me datën 19.06.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga PDK lidhur me ankesën e paraqitur nga LVV-ja, ku në mënyrë kategorike i mohon pretendimin ankimore duke deklaruar se Jeton Tifeku nuk e ka penguar vëzhguesin Ngadhjim Hagjosaj për tu shënuar në LV.

Po ashtu PZAP-i përmes postës elektronike njoftoi edhe kryesuesin e VV 0706D/02R Jeton Tifekun lidhur me ankesën e parashtuar nga subjekti politik LVV dhe kërkoi nga ai që të përgjigjet lidhur me ankesën në fjalë.

Nga përgjigja e ofruar në PZAP nga ana e Jeton Tifekut theksohet se pretendimet e parashtruara në ankesë nuk janë të vërteta pasi që vëzhguesi Ngadhënjim Hagjosaj ka shënuar vërejtjet për të cilat si dëshmi ekziston edhe ditari.

PZAP-i, më datë 18.06.2012, ka kërkuar Librin e Votimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për Vendvotimin 0706D/02R.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

PZAP-i, vlerëson se pretendimet ankimore të subjektit politik LVV se kryesuesi i VV 0706/02R Jeton Tifeku nuk e ka lejuar vëzhguesin e LVV-së Ngadhënjim Hagjosaj të shkruaj vërejtjet e tija tek libri i votimit nuk qëndrojnë për faktin se në Librin e Votimit për VV 0706D/02R, në të janë shënuar dhe nënshkruar vërejtjet e dhëna nga Ngadhënjim Hagjosaj. Andaj PZAP-i, konstaton se ankesa është e pa bazuar në fakte dhe prova të cilat do ti bënin të besueshme pretendimet e tilla ankimore. Prandaj një pretendim i tillë i ankimor u vlerësua si i pabazuar në prova bindëse dhe të besueshme. Për arsyet e dhëna me lartë, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

A nr. 185/2012 më datën 21.06.2012.

